

Informacion Kryesor Për Investitorin

Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi Fondin Raiffeisen Invest Euro. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohet me Ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe risqet që shoqërojnë investimin në fond. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo në këtë fond.

FONDI I INVESTIMIT RAIFFEISEN INVEST EURO

është sipërmarrje Investimesh Kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, që administrohet nga Raiffeisen Invest – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.

Kuotat e Fondit nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në fondin Raiffeisen Invest Euro nuk është një investim i garantuar, fondi nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve, dhe risku i humbjes së principalit përballohet nga investitori.

Objektivat dhe Politika e investimit*

Objekti i Fondit është të jetë likuid dhe të rrisë të ardhurat nga investimi në një horizont afatmesëm, duke ruajtur nivelin e kapitalit. Asetet e fondit investohen në 2 kategori: Tituj borxhi dhe Tregu i parasë / ekuivalentë cash-i. Fondi investon në Tituj borxhi, të emetuara ose garantuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë deri në 60%, në Tituj borxhi të emetuara ose garantuara nga shtete të tjera sovraane të tregtuara në tregje të rregulluara ose bursat zyrtare të shteteve të BE-së apo çdo shtet tjetër të lejuar nga AMF-ja deri në 20%, si edhe në kuota të fondeve të investimit si një tjetër formë diversifikimi. Fondi mund të investojë gjithashtu edhe në tituj borxhi të emetuara nga autoritetet vendore ose shoqëri tregtare, të tregtueshëm në tregje të rregulluara ose bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë deri në 30%.

Asetet e Fondit mund të përbëhen nga depozita bankare afatshkurta, cash në llogari rrjedhëse dhe marrëveshje të anasjellta të riblerjes në funksion të menaxhimit të likuiditetit deri në masën 80% të aseteve të fondit. Fondi përcakton natyrën e investimeve të aseteve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Fondi menaxhohet pa ju referuar një standardi. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetë zbutja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit. Të ardhurat e fondit nuk shpërndahen por ri-investohen. Moneda baze e Fondit është Euro. Investimet dhe shlyerjet bëhen në Euro.

Shitja e kuotave të fondit mund të bëhet në çdo kohë nga ana e investitorit me kërkesë të tij, shlyerja e tyre bëhet brenda afatit ligjor prej 7 ditësh nga dita e mbërritjes së një kërkesë të vlefshme për shitje.

Performanca e Fondit dhe rrjedhimisht edhe vlera e investimit mund të luhatet në varësi të kushteve të tregut. Luhatja e normave të interesit të instrumenteve financiare në të cilat fondi investon është faktori kryesor i cili ndikon në performancën e fondit. Kostot e transaksioneve nuk kanë një ndikim material mbi performancën e fondit.

Rekomandim: Ky fond mund të mos jetë i përshtatshëm për investitorët që synojnë të tërhiqen nga fondi brenda 2 viteve.

Fondi nuk duhet të përdoret si një llogari rrjedhëse, por si një menyrë investimi afatmesme pasi qëndrimi shumë i shkurtër në fond mund të rezultojë në një kthim të pakënaqshëm.

*Për më tepër informacion mbi objektivat e investimit jeni të lutur ti referoheni prospektit të Fondit Raiffeisen Invest Euro.

Profili i Risk dhe Përfitimit

Risk i ulët

Potencial Përfitimi më i ulët

Risk i lartë

Potencial Përfitimi më i lartë

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

- Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit ka për qëllim ti japë investitorit një ide mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës. Treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë.
- Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.
- Kategoria e treguar e riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës.
- Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.
- Bazuar në të dhënat historike të kthimeve të fondit gjatë 5 viteve të fundit, profili i parashikuar i riskut të fondit i përket kategorisë 3 të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit (SRRI=3).

Risqe me rëndësi materiale të cilat nuk mbulojnë tërësisht nga treguesi i riskut sintetik dhe përfitimit:

Risku i kreditit: ky risk lidhet me mundësinë që emetuesi i një

instrumenti financiar, pjesë e aseteve të Fondit, të mos jetë në gjendje të shlyejë pjesërisht ose plotësisht të gjitha detyrimet e tij, cka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e aseteve të Fondit. Ky risk rritet kur Fondi është i ekspozuar në tituj me "nëngradë investimi".

Risku i likuiditetit: risku që një aset të mos shitet shpejt dhe me një çmim të përafert me vlerën e tregut.

Risku i palës tjetër: risku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonesë. Gjithashtu ky risk lidhet me

mundësinë që pala tjetër të mos jete në gjendje të realizojë pagesat sipas kushteve të një marrëveshjeje apo transaksioni të paracaktuar.


Risku operacional: risku i humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabimet njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e marketingut, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit.

Komisionet dhe tarifat

Komisionet dhe tarifat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit Raiffeisen Invest Euro, duke përfshirë këtu kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të fondit. Këto komisione dhe tarifa zvogëlojnë rritjen potenciale të investimit.

Komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit	
Komisioni/tarifa e hyrjes	0.00%
Komisioni/tarifa e largimit	0.00%
Komisione/tarifa të vazhdueshme që mbahen gjatë 1 viti	1.48%
<p>Shifra e tarifës së vazhdueshme mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2022. Tarifa e vazhdueshme përfshin tarifën e administrimit dhe çdo tarifë të vendosur gjatë vitit të shkuar. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifat e vazhdueshme që paguhet nga asetet e fondit në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë 1.60% në vit të vlerës neto të asetëve të fondit. Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit. Lutemi referojuni zërit "Shpenzime" të raportit vjetor të fondit për detaje të mëtejshme lidhur me komponentët e tarifës së vazhdueshme. Për më tepër informacion rreth kostove/tarifave, jeni të lutur ti referoheni seksionit 2.15 të prospektit të Fondit të publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese: www.raiffeisen-invest.al.</p>	
Komisione/tarifa të veçanta	
Komisioni/tarifa e Performancës	E paaplikueshme

■ Paraqitja e performancës së shkuar



Performanca e shkuar shërben vetëm për qëllime informative dhe nuk përfaqëson premtim apo garanci për performancën e fondit në të ardhmen. Performanca e treguar në grafik është kthimi neto i fondit, pasi është zbritur tarifa e vazhdueshme vjetore. Fondi ka filluar veprimtarinë e tij në 17 Tetor 2012. Performanca e shkuar është e llogaritur në monedhën Euro.

■ Informacione Praktike

- Banka Depozitare është Banka e Parë e Investimeve sh.a.
- Kopje të prospektit dhe raporteve më të fundit të ecurisë së Fondit mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.raiffeisen-invest.al, si dhe pranë degëve të Raiffeisen Bank sh.a.
- Cmimi i kuotës së fondit publikohet çdo ditë në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese: www.raiffeisen-invest.al, ku mund të gjeni informacion më të detajuar mbi fondin.
- Regjimi tatimor në fuqi në Republikën e Shqipërisë aplikohet mbi të ardhurat e realizuara, të cilat rezultojnë nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave në fond.
- Raiffeisen INVEST sh.a. është përgjegjëse e vetme për çdo informacion/deklaratë të përfshirë në këtë dokument që është çorientues, i pasaktë ose në kundërshtim me pjesët përkatëse të prospektit të fondit.

Ky fond është i licencuar dhe rregullohet në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Raiffeisen INVEST sh.a është e licencuar dhe rregullohet në Republikën e Shqipërisë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Ky dokument me informacionin kryesor për investitorin është i saktë në datën e publikimit 20 Shkurt 2023.